




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 256/2020
Datë: 18 nëntor 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafi 1, pika 1.1., 1.6, 1.9, 1.12 dhe 1.17 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 13 paragrafi 1 pika 1.1, neni 18, neni 24 paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, si dhe neni 7 i Rregullores nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funksionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, në mbledhjen e 242-të, të mbajtur me datë 18 nëntor 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Ndryshohet vendimi KGJK.nr.171/2020, të datës 03 korrik 2020, paragrafi 2 pika 4, për themelimin e Komisionit për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Departamentit Special.
- II. Z. Cerim Fazliji, anëtar i KGJK-së, caktohet anëtar rezervë, në vend të z. Avni Mehmeti.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 18 nëntor 2020.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 3 korrik 2020, me vendimin KGJK.nr.171/2020, ka themeluar Komisioni për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Departamentit Special, mirëpo për shkak se z. Avni Mehmeti, anëtar i KGJK-së, përkatësisht anëtar rezervë në këtë komision ka kërkuar tërheqjen nga ky komision, ndryshohet paragrafi 2 pika 4 i vendimit të lartcekur, në vend të gjyqtarit Avni Mehmeti, anëtar rezervë i këtij komisioni, caktohet Cerim Fazliji.

Me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të mëtutjeshme për proceset, KGJK, konform nenit 7 i Rregullores nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funksionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Skender GOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.